



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 627 Prot.

Gjirokastrë, më 12 105 / 2023

Lënda: Hapet thirrja për aplikime për programe postdoktorature në kuadër të Horizon Europe MSCA Postdoctoral Fellowships with the University of Jaén, Spain

Universiteti Jaén, Spanjë mirëpret aplikantë për programe postdoktorature.

Bursat Postdoktorale MSCA Horizon Europe u ofrojnë aplikantëve të suksesshëm një kontratë me kohë të plotë me një pagë shumë konkurruese për të punuar në një projekt kërkimor dhe për t'u angazhuar në trajnime të avancuara.

Kriteret e pranueshmërisë për aplikim janë:

- Mbajtja e një diplome doktorature (Aplikantët që kanë mbrojtur me sukses tezën e doktoraturës, por që ende nuk kanë marrë zyrtarisht diplomën gjithashtu do të konsiderohen);
- Një maksimum prej tetë vjet përvojë në kërkime, nga data e dhënies së doktoraturës së tyre (Vitet e përvojës jashtë kërkimit dhe periudhat e pushimit nuk do të llogariten);
- Të mos kenë banuar ose kryer aktivitetin e tyre kryesor (punë, studime, etj.) në Spanjë (për Bursat Evropiane Postdoktorale).

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë CV-në e tyre dhe përmbledhjen e projekt-propozimit (250 fjalë) në Zyrën e Projekteve Ndërkombëtare të UJA R&I (ofipi@ujaen.es) deri më 15 maj 2023.

Lista e mbikëqyrësve të mundshëm në Universitetin e Jaén është në dispozicion në faqen e internetit të OFIPI dhe do vazhdojë të përditësohet deri në datën e lartpërmendur.

Prof. dr. Bektash Mema

REKTOR

